

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



7-13 KORRIK JAVA E MBROJTJES



INVESTIMET NË BMEC

Ministri i Mbrojtjes **Pirro Vengu** vizitoi Bazën e Mbështetjes për **Emergjencat Civile**, ku u takua me efektivët e Forcave të Armatosura, që **angazhohen** çdo ditë në ndihmë të komunitetit për përballimin e situatave të vështira emergjente. Vengu vlerësoi **investimet** e kryera në dy vitet e fundit. Ai **theksoi** se, këto janë vetëm hapat e parë drejt një modernizimi të plotë.

★★★★★



FORCA DETARE SHPËTON TRE PERSONA

Forca Detare finalizoi me sukses një operacion shpëtimi në Gjirin e Gramës, ku një velierë me tre persona në bord pësoi defekt në motorë. Pas marrjes së sinjalit të ndihmës, anija P-116 “BORA” ndërhyri menjëherë, duke shpëtuar personat. Operacioni u zhvillua në bashkëpunim me Policinë Kufitare të Vlorës dhe Qendrën Kombëtare të Koordinimit të Kërkim-Shpëtimit Detar.

★★★★★

mod.gov.al


JM



FA TË ANGAZHUARA NË SHUARJEN E ZJARREVE

Efektivë të Forcave të Armatosura dhe mjete janë angazhuar gjatë kësaj jave në **shuarjen** e zjarreve që përfshinë vendin, në bashkëpunim me strukturat e **zjarrfikëseve** dhe emergjencave **civile** vendore. Pjesa më e madhe e vatrave tashmë janë vënë nën kontroll. Të gjitha **strukturat** mbeten në gatishmëri për të **menaxhuar** me sukses situatat e zjarreve, të shkaktuara nga temperaturat e larta.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI VENUGU FALËNDERON FORCAT E EMERGJENCAVE CIVILE

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, së bashku me ministrin e Brendshëm, **Ervin Hoxha** inspektuan landfill-in në Elbasan, pas një **zjarri** që përfshiu zonën ditët e fundit. Vengu vlerësoi punën e strukturave **zjarrfikëse**, emergjencave civile vendore, FA-ve dhe të gjithë institucioneve të përfshira në **menaxhimin** e **situatës**. Ministri i Mbrojtjes tha se situata të tilla nxjerrin në pah domosdoshmërinë e **modernizimit** të plotë të sistemit të emergjencave civile në vend.

★★★★★

Raundi 1

8 Korrik – 28 Korrik

29 Korrik – 03 Gusht

AFA ÇEL APLIKIMET PËR VITIN E RI AKADEMIK

Aplikim Online

ualbania.al 🔍

Akademia e Forcave të Armatosura ka çelur **aplikimet** për vitin akademik **2025–2026**. Të rinjtë dhe të rejat që synojnë një karrierë ushtarake dhe arsim **akademik** cilësor në disa **drejtime** të rëndësishme, mund të aplikojnë tashmë online përmes portalit zyrtar **ualbania.al**

Publikimi i renditjes
së aplikantëve në

ualbania.al

★★★★★

mod.gov.al

JM



67 KURSANTË DIPLOMOHEN NË KOLEGJIN E MBROJTJES

U përmbyll me sukses **Kursi** i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursi i Lartë i Oficerit në **Kolegjin** e Mbrojtjes dhe Sigurisë. **67 kursantë** nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Forca e Sigurisë së **Kosovës** përfunduan me **përkushtim** këtë fazë të rëndësishme të trajnimit të tyre.

JM





BIG BAND, OSFA NË TURIN VEROR

Pas ndalesave në Durrës, Pogradec, Himarë, Vlorë, Tiranë, Berat, Shëngjin dhe Porto Palermo, këtë javë **turi koncertor i BIG Band**, në kuadër të sezonit turistik, u ndal në Shkodër dhe Elbasan. Ndërkohë, **OSFA** ndodhet në Korçë për dy koncerte në bashkëpunim me "**Mik Festival**". Turi i kësaj vere do të vijojë me pas në Sarandë, Gjirokastër, Pashaliman, **Velipojë etj**

JM





BASHKËPUNIMI STRATEGJIK 2025–2028, SHQIPËRI–KOSOVË

Në Tiranë u diskutua Plani i Bashkëpunimit Strategjik Shqipëri–Kosovë 2025–2028 mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ky plan forcon bashkëpunimin ushtarak dhe marrëdhëniet vëllazërore, me Shqipërinë që do mbështesë Kosovën në arsimim, stërvitje, shkëmbim eksperiencash dhe ndërtim kapacitetesh, për një siguri më të fortë në rajon.

★★★★★





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

PËRGATITJET PËR “CAMBRIAN PATROL 25”

Në Batalionin e Parë të Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut po zhvillohen përgatitje intensive për garën ndërkombëtare “Cambrian Patrol 25”, që do të mbahet në tetor në Uells, Britani e Madhe. Ushtarët trajnohen në marshim taktik, kalim traversash dhe pengesash ujore, topografi dhe ndihmë të parë në terren, duke forcuar aftësitë individuale dhe bashkëpunimin me aleatët.

★★★★★

mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



TURIZËM “PËRMES TINGUJVE”

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura po vijon turin muzikor Turizëm “Përmes Tingujve” në qytete të ndryshme të vendit, ndërsa performanca e fundit u realizua në **Durrës**, ku u **luajtën** pjesë të huaja dhe shqiptare të mbështetura në folklor.

JM

